



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.97/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Pejë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të vendosjes së posterit në vend publik, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 03.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Pejë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 1.450,00 euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (VV), me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, më datë 29.09.2017, me të cilën pretendon se aktivistët e tyre, kanë vërejtur se në Rrugën Transit të Komunës së Pejës, në shtylla elektrike janë vendosur postera të kandidatit për Kryetar dhe kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal të Pejës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 33 pika b, të LZP-së, dispozitës së nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të datës 02.10.2017, subjekti politik LDK, ankesën e subjektit LVV e konsideron si të pabazuar për faktin se afër 24 orë prej pranimit të ankesës zyrtarët e degës së LDK-së në Pejë, nuk kanë arritur ta gjejnë posterin si në foton e bashkangjitur. Parashtruesi i ankesës potencon se pasi nuk kanë mundur të gjejnë foton deri në afatin e dorëzimit të përgjigjes në PZAP dyshojnë se subjekti ankues e ka vendosur vetë, me të cilën e kanë fotografuar për ta bërë ankesën dhe të njëjtin e kanë hjekur vetë.

Pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, LDK ka ndërmarr masat përmirësuese me të cilën kanë fotografuar shtyllën ashtu siç e kanë identifikuar në ankesë dhe të cilën nuk kanë qenë posterat, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur fotografi me të cilën nuk shihen posterët e LDK-së për të cilët është parashtruar ankesa.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

**Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterët e kandidatit për Kryetar dhe anëtar të Kuvendit Komunal të Pejës, nga radhët e LDK-së, janë vendosur në shtylla elektrike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterët e kandidatëve për Kuvend Komunal të Pejës nga radhët e subjektit politik LDK janë vendosur në shtyllë elektrike.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes duke fotografuar shtyllën elektrike me arsyetimin se nuk ka pasur postera sipas ankesës së parashtruar ndaj tyre, pretendimet e tilla nga ana e panelit janë të paqëndrueshme, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi me këtë gjob paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr. 97/2017 më datën 03.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Hasan Shala**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.